



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Datë: 26.01.2026

PROCES-VERBAL

Këshilli BashkiaK Kamëz i mbledhur sot, në dt. 26.01.2026, në orën 16:00, në mbledhjen e radhës të muajit Janar 2026 në sallën e Këshillit BashkiaK, Bashkia Kamëz. Të pranishëm në mbledhje janë 24 anëtar të Këshillit, përfaqësues nga administrata e Bashkisë. Mbledhja mbahet nga Kryetari i Këshilli BashkiaK z.Hysen Koldashi i cili hap mbledhjen me fjalët përshëndetëse.

Koldashi: Sipas njoftimit nga sekretaria mbi bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në rregulloren e Këshillit BashkiaK 33 datë 21.03.2024; Neni 81 pika 1, sot zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit BashkiaK.

Koldashi: Përpara se ta fillojmë, i kalojmë fjalën sekretarisë për prezencën. Ju lutem, sekretaria.

- Sekretaria konfirmon pjesëmarrjen e Këshilltarëve.

Koldashi:Paraprakisht hedhim në votim Proces-verbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit BashkiaK. E hedhim në votim. 24 vota Pro; 0-Kundra; 0-Abstenim.

Koldashi: Faleminderit! Atëherë, me rendin e ditës jeni njohur, e keni të printuar në tavolinën tuaj, si më poshtë vijon:

1. Projekt-Vendim Nr.91 datë 29.12.2026 për: “Miratimin e efekteve financiare ekonomike të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.
2. Projekt-Vendim Nr.02 datë 20.01.2026 për: “Miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato familje në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë për vitin 2026”.
3. Projekt-Vendim Nr.04 datë 20.01.2026 për: “Miratimi i listës së familjeve që përfitojnë nga programi strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë”.
4. Projekt-Vendim Nr.05 datë 20.01.2026 për: “Dhënien e pëlqimit në parim për përdorimin e pronës për ngritjen e strehëzës së kafshëve endacake në Bashkinë Kamëz”.
5. Projekt-Vendim Nr.06 datë 23.01.2026 për: “Një ndryshim në vkb nr.89, datë 17.12.2025 për, “Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”.
6. Projekt-Vendim Nr.01 datë 20.01.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.
7. Projekt-Vendim Nr.03 datë 20.01.2026 për: “Miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike gjatë vitit 2025 për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikezimit, të cilat do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike dhe trajtimin me ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i Bashkisë Kamëz për vitin 2026”.
8. Ndryshim emërtimi rruge në territorin e Bashkisë Kamëz.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

9. Të ndryshme.

Koldashi: Pyetje-Diskutime: S'ka, E hedhim në votim rendin e ditës. 24-Vota Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimet me radhë sipas rendit të ditës. Kemi projektvendim nr.91, data 29.12.2006, për: "Miratimin e efekteve financiare ekonomike për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Dr. përkatëse të japi shpjegimit.

Vjollca Smaçi (Dr.Financës): Përshëndetje! Ky projektvendim konsiston në heqjen nga inventari të materialeve, pasi është bërë ndryshim destinacion, pasi tek ish-fusha e sportit po bëhet ndërtimi i parkimit nëntokësor dhe i ndërtesës së bashkisë. Për këtë arsye, e kemi sjellë këtë projektvendim që të miratohet nga ana juaj. Bashkëlidhur është një listë analitike që i tregon të detajuara me statistika. Për çdo paqartësi jam e gatshme për përgjigje.

Koldashi: Faleminderit, drejtoresha. Këshilltar, ka pyetje? Diskutime, pa qartësi? Nuk ka! E hedhim në votim. 24-Vota Pro; 0-Kundra; 0-Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Projektvendim numër 02, datë 20.01.2006, për "Miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për atë familjen në nevojë, të cilët nuk përballojnë qiranë për vitin 2006". Nëse ka pyetje nga këshilltarët? Pyetje? Ndonjë paqartësi? Për ta sqaruar, kemi edhe përfaqësues të zyrës së drejtorisë. Nuk ka. E hedhim në votim. 24 Vota Pro, 0-Vota Kundra, 0-Vota Abstenim, Miratohet.

Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin numër 04, datë 21.2006, për; "Miratimin e listës së familjeve që përfitojnë me programin e strehimit social, subvencionimi i interesave të kredisë. Këshilltarë, kemi pyetje? Nuk ka. Një diskutim, paqartësi? E hedhim në votim. 24-Vota; Pro, 0-Vota Kundra; 0-Abstenim; Miratohet.

Koldashi: Viojmë me projektvendim numër 05, datë 20.01.2006, për: "Dhënien e pëlqimit në parim për përdorimin e pronës për ngritjen e strehëzës së kafshëve endacake në Bashkinë e Kamzës". Kush është përfaqësuesi nga bashkia mund të dhënë shpjegime? Sa më shkurt, pastaj, nëse ka pyetje, mund të japim përgjigje më të detajuara.

Fatjon Lleshi (Dr.mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar): Përshëndetje. Paraqesim para jush pv i cili ka bërë nga ankesat e shumta të drejtuara nga qytetarë të bashkisë dhe njërive të shërbimit shëndetësor për kafshët endacake nëpër rrugë. Qëllimi është minimizimi i tyre, pasi sjellin problematika si: frikë, sëmundje etj.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**



Koldashi: Një pyetje kisha unë. Vendndodhja, ku do të ndërtohet? Ku mendohet aktualisht?

Fatjon Lleshi: Valias , Kamëz. Është pronë e bashkisë prej 1000 m².

Nazif Sulaj Këshillt.: Kur mund të fillojë mobilizimi?

Fatjon Lleshi: Shumë shpejt. Sapo të kryejmë mbylljen e procedurave.

Enver Buci Këshillt: Shpresojmë që të çohet deri në fund ky shqetësim se me të vërtetë është problem për qytetarët. Sigurisht, do të keni mbështetjen e Këshillit. Vota është pro për këtë çështje.

Koldashi: Faleminderit, zoti Buci, për mbështetjen tuaj dhe grupit tuaj. Problemi është që iniciativa, kemi iniciativë të japim dhe shpresojmë, meqë nga bashkia është marrë si iniciativë, atëherë kanë marrë parasysh edhe të gjithë efektet financiare të tjerë dhe vendndodhja dhe trulli, siç e tha dhe përfaqësuesi i bashkisë. Këshilltarë, kemi pyetje? Nuk ka. Një diskutim, paqartësi? E hedhim në votim?. 24-Vota Pro; 0-Vota Kundra; 0-Vota Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Projektvendim numër 06, datë 23.01.2006, për: “Një ndryshim në VKB-në numër 89, datë 17.12.2025, për sistemin e taksave të tarifave vendore”, Është një ndryshim shumë i vogël, shumë thelbësor, për detaje kemi N/Kryetarin e Bashkisë. Po i nderuar.

Gentjan Bicukaj N/Kr i Bashkisë: Përshëndetje! Të nderuar këshilltarë, kemi do bëjmë vetëm një nënkategorizim të taksave të ndikimit në infrastrukturë. Domethënë institucionet publike në momentin që kryejnë një investim në territorin e bashkisë së Kamëz do ta kenë sipas ligjit taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerë 1%. Domethënë, vetëm kjo do shtohet si pikë, një pikë nënkategorizim. Pjesa tjetër nuk do të ndryshojë asnjë gjë.

Koldashi: Vetëm për institucionet publike kur kryejnë një investim. Jo private fare, vetëm publike, se kur i kaluam në paketë kanë qenë të njëjta dhe publike dhe private. Dhe ky është ndryshimi. Ka ku paqartësi tjetër? Nuk ka. E hedhim në votim.. 24-Vota Pro; 0-Vota Kundra; 0-Vota Abstenim. Miratohet.

Koldashi: . Projektvendim numër 01, datë 20.01.2006, për: “Dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6%”. Këshilltarë, kemi pyetje? Nuk ka. Ndonjë diskutim, paqartësi? E hedhim në votim?. 24-Vota Pro; 0-Vota Kundra; 0-Vota Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Kemi projektvendimin numër 03, datë 20.01.2006, për: “Miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike 6% . Janë kriteret që do ketë drejtoria përkatëse për të vendosur



dhënien e ndihmave ekonomike pëgjatë vitit 2026. Atëherë, Pyetje-s'ka! Jo, diskutime! Paqartësi apo diçka tjetër? Nuk ka!.E hedhim në votim.. 24-Vota Pro; 0-Vota Kundra; 0-Vota Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Dhe pika e fundit ka të bëjë me dy ndryshime emrash të disa rrugëve dhe një vendosje emërtimi pasi është pa emër. T'i marrim me radhë. Kemi rrugën nga: Mat-Mirdita - në Lagjen1 Valias. Kemi përfaqësues nga komisioni, kush e mbron? Po, ju lutem shumë shkurt, konkretisht.

Bajram Burreli : Përsëritet Komisioni i verifikimit sëbashku me përfaqësues nga njësia, pasi u njoh me shkresën e banorëve dolëm në terren për verifikime. Grupi verifikoi mbi bazë të procedurave që ndiqen, takimi banorët, diskutimeve.. , mbajtëm procesverbalin e konstatimit . Banorët e asaj rruge ishin dakord për ndryshim, sipas tyre të gjithë banorët ishin nga Mirdita.

Koldashi: Ju falenderoj për shpjegimin në detaj. Në atë lagje, kam qenë e unë, nuk kishte asnjë Matian të gjithë ishin nga Mirdita.

Nazif Sulaj: Faleminderit zoti kryetar, por kjo ndryshimi i emrave duhet parë me kujdes, se realisht situata e emërtimeve të rrugëve në Kamëz është e trashëguar. Në qoftë se doni me hyrë me themel të bëhet diçka cilësore, ne jemi gati të diskutojmë, të ngrihet një komision dhe të bëhet me standarde që mund t'i rezistojë kohës edhe për 20, 30 vite ose 50 vite.

Koldashi: Faleminderit për opinionin tuaj. Respektoj zotin Sulaj. Problemi është që këtë unë e kam thënë në krye të herës dhe jam koherent me veten se në momentin e parë kur mos jem koherent me veten, unë skuqem fytyrën si pozicion punë në mënyrë kategorike. E tha dhe zotëria që shpjegoj, është rrugë pa dalje, kemi të bëjmë me segmente rrugësh. Kemi ndryshuar vetëm një rrugë deri më sot gati dy mandate, vetëm rrugën “Demokracia” me “Lazam Troci” që është rrugë kryesore dhe asnjë rrugë tjetër nuk i është ndryshuar emri. Kryetari i bashkisë në takimet ku ka qenë pranë këshillit bashkiak ju ka bërë thirrje juve dhe po e përsëris, ju lutem komunikoni me zonat, komunikojmë bashkë, bashkëpunojmë të gjejmë emrat që duhen të vendosur. Këshilltarë, kemi pyetje, diskutime të tjera? S'ka! E hedhim në votim. 22 Vota Pro; 2 Vota Kundra; 0-Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Kalojmë tek rruga e dytë. Kemi të bëjmë tek lagja Bathore. E ka patur emrin “Kashar” dhe është propozuar nga banorët për emërtimin “Mustafa Basha”. Mustafa Basha ka qenë një mësues që ka punuar profesor te shkolla e Bulçeshit dhe nuk jeton më sot. Ka vdekur. Është propozuar ka kohën. Është kërkuar nga pothuajse nga gjithë zona e Bulçeshit. Grupi i Komisionit ka shku në terren, ku kanë diskutuar me banorët dhe është mbajtur dhe procesverbali. Një pjesë ndoshta nga ju e keni patur fatin ta njihni profesorin. Ai ishte profesor. Ka kush di



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ



diçka për të shtuar ose për të hequr? Këshilltarë, kemi pyetje, diskutime të tjera? S'ka! E hedhim në votim?. 24 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Koldashi: Dhe rruga e fundit ka të bëjë po në Valiaz. Rruga ka qenë pa emër dhe është kërkuar të emërtohet "Zajsi". Është rrugë diku më pak se 150 metra. Është rrugë pa emër, ka qenë ajo është hap rruga e re. Nëse doni ta shpjegojmë më shumë, e kemi përfaqësuesin tonë. Nëse s'doni, mund të vazhdojmë me me votim. Ka kush pa qartësi për pyetje konkrete direkte? E hedhim në votim?. 24 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Atëherë, duke ju falenderuar për kontributin tuaj me votë dhe gjithë projektvendimet e paraqitura nga nga bashkia, kthehen në vendime. Kalojmë në pikën e fundit tek ndryshme. Kush e do fjalën? Nëse ka kush diçka për të thënë, nuk ka. Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Mbledhja e radhës njoftohet nga sekretaria dhe rrjetet sociale.

SEKRETARI

Shënimje Topi